



KONTRATE SHITBLERJE
E PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Sot ne Tirane, me date 21.08.1997, u paraqiten personalisht palet kontraktuese dhe redaktuan kete kontrate shitblerje te pjeseve te kapitalit themeltar te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "B.N.T. Electronics"

SHITESI: ROBERT NIKOLLA, i biri i Thomait, lindur me 1961 dhe banues ne Tirane, Lagjja Nr. 3, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me leternjoftimin AZ Nr. 474128.

Ne baze te Vendimit Nr.4409 date 24.05.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane per rregjistrimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "B.N.T. Electronics" zoterinjte Robert Nikolla, Leonard Terpo dhe Jovan Bojdani jane bashkeortake ne kapitalin themeltar per shumen 100 000 (njeqind mije) leke me kuote perkatese : Robert Nikolla ne masen 33% qe kap vleren 33 000 (tridhjete etre mije) leke, Leonard Terpo ne masen 33 % qe kap vleren 33 000 (tridhjete e tre mije) leke dhe Jovan Bojdani ne masen 34 % qe kap vleren 34 000 (tridhjete ekater mije) leke.

Pjesen e tij tekapitalit themeltar prej 33% ne vleren 33 000 (tridhjete etre mije) leke Shitesi Robert Nikolla ua shet ne pjese te barabarta te dy ortakeve tetij ne masen 16.5 % me vlere 16 500 (gjashtembedhjete mije e peseqind) leke.

BLERESIT: 1) LEONARD TERPO, i biri i Todos, lindur me 1953 dhe banues ne Tirane, Lagjja Nr. 2, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me leternjoftimin NF Nr. 481633,

2) JOVAN BOJDANI, i biri i Todos, lindur me 1956 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me certifikaten e lindjes Nr. 5/15 date 24.05.1996 leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Nr.8 Tirane,

jane dakord te blejne pjesen e kapitalit themeltar te ish ortakut te tyre Robert Nikolla ne masen 33 % ne vleren 33 000 (tridhjete e tre mije) leke dhe i paguan bashkerisht peshim ne dore shumen 33 000 (tridhjete e tre mije) leke. Me nenshkrimin e kontrates dhe noterizimin e kesaj kontrate ish - ortakut Robert Nikolla humbet çdo te drejte pronesie ne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "B.N.T. Electronics" dhe pronare te vetem te saj mbeten Leonard Terpo dhe Jovan Bojdani ne pjese te barabarta.

Kjo kontrate shitblerje u redaktua ne kater kopje origjinale, dy kopje i mbajne bleresit, nje kopje shitesi dhe nje kopje noterja.

SHITESI
ROBERT NIKOLLA

BLERESIT
LEONARD TERPO JOVAN BOJDANI